



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 74

Prishtinë, më 28.06.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

**Munguan:** Doruntinë Maloku, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Kosovare Maliqi- Rrokum; Dren Ajeti- GLPS; Valentina Demolli-KMDLNJ; Sanije Berisha- OSBE; Mergime Kajtazi-KDI dhe Egzon Pacolli – praktikant.

**Mbledhjen e kryesoi** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Nga Stafi Mbështetës:** Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 31.05 dhe 7.06.2016;
3. Propozimi i anëtarit në Komisionin për Kompensimin e viktimave të krimit;
4. Shqyrtimi i rekomandimeve të institucioneve që bien në fushëveprimin e Komisionit lidhur me kërkesat buxhetore për vitin 2016;
5. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve kryesore në Projektligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje;
6. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua me ndryshime duke u hequr pika e pestë e rendit të ditës.*

## 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 31.05 dhe 7.06.2016

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 31.05 dhe 7.06.2016, pa vërejtje.

## 3. Propozimi i anëtarit në Komisionin për kompensimin e viktimave të krimit

**Kryetarja** tha se në Komision ka ardhur një kërkesë ku kërkohet, në përputhje me ligjin 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit neni 23 nënparagrafi 1.3, i cili për anëtar të Komisionit të viktimave të krimit përcakton një anëtar të Kuvendit të Republikës së Kosovës i propozuar nga radhët e anëtarëve përkatës të Komisionit për Legjislacion. Znj. Haxhiu i ftoi anëtarët e Komisionit të marrin fjalën për propozime.

**Selvije Halimi** propozoi z. Nezir Çoçaj që të jetë anëtar i Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nga radhët e Komisionit për Legjislacion.

**Armend Zemaj** tha se vetëm po e konfirmoj se person i duhur dhe i qëlluar është z. Çoçaj për këtë Komision dhe Ligjin që e kemi miratuar para disa muajve më vjen mirë që tani kanë filluar ta zbatojnë dhe besoj se z. Çoçaj do ta përfaqësojë Komisionin në mënyrën më të mirë të mundshme.

**Kryetarja** duke pasur parasysh faktin se Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit me gjasë ka të bëjë më shumë me gratë për shkak se viktimat më të mëdha sot janë gratë për shkak të dhunës në familje duke mos i përjashtuar edhe burrat. Dëshira ime do të ishte që në këtë Komision të shkonte ndonjë grua që është anëtare e Komisionit për legjislacion, madje do të propozoja nënkryetaren e Komisionit, znj. Selvije Halimi.

**Selvije Halimi** e falënderoi kryetaren, por tha se ligji nuk përcakton gjininë që të marrë pjesë, pavarësisht detyrat që i ka dhe ajo çfarë është e rëndësishme është që të jetë një person i përkushtuar për punën që ka të bëjë me kompensimin e viktimave të krimit dhe qëndroj pranë propozimit tim për z. Nezir Çoçaj.

*Meqë nuk kishte më diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash mori këtë*

## V e n d i m

Z. Nezir Çoçaj, deputet dhe anëtar i Komisionit për Legjislacion, emërohet anëtar në Komisionin për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

#### **4. Shqyrtimi i rekomandimeve të institucioneve që bien në fushëveprimin e Komisionit lidhur me kërkesat buxhetore për vitin 2016**

**Kryetarja** tha se po i shqyrtojmë një nga një kërkesat dhe po fillojmë me Ministrinë e Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë ka kërkuar staf shtesë prej 10 pozitash në vlerë prej 127.427.19 €, Avokatura e Shtetit shuma prej 41.806.80 € për nivelimin e pagave të avokatëve të shtetit, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar rritje 3 pozita me shumë prej 7.948.39 €, Departamenti për Profesionet të Lira 7 pozita në shumë prej 19.320.00 € dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës, shuma prej 58.352.00 për kompensimin e punës së natës, festave shtetërore dhe rekrutimin e pozitave të lira të buxhetuara. Znj. Haxhiu e ftoi të marrë fjalën znj. Halimi, si kryesuese e Grupit Punues lidhur me këto kërkesa.

**Selvije Halimi** tha se ne kemi mbajtur një takim, ku Komisioni ka ftuar përfaqësues të këtyre institucioneve të cilat bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion dhe është kërkuar që rekomandimit për mbështetje buxhetore t'i dërgojnë me shkrim. Grupi punues në takimin e mbajtur u dakordua që t'i ndahet buxhet shtesë Ministrisë së Drejtësisë për kërkesat e paraqitura në shkresën e datës 2.06.2016 dhe t'i ndahet buxhet shtesë Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas për ri-funksionalizimin e zyrave për ndihmë juridike falas në Ferizaj dhe Gjakovë. Ndërsa sa i përket kërkesave buxhetore nga institucionet e tjera, menduam që nuk ka nevojë t'i japim përparësi për rishikimin, por si do që të jetë është çështje vendimit të Komisionit se a do t'i përkrahë këto që ka vendosur grupi punues, apo do të shtojmë edhe ndonjërin nga kërkesat e tjera të institucioneve për buxhet shtesë për realizimin e planeve të tyre për vitin 2016.

**Kryetarja**- Në fakt unë përkrah të gjitha kërkesat e Ministrisë së Drejtësisë dhe ajo çfarë unë nuk përkrah është te Këshilli Gjyqësor i Kosovës lejimin e vizitave për gjyqtarë që është e bazuar me një marrëveshje që është tërësisht antikushtetuese e cila është Marrëveshja për Drejtësi e nënshkruar vitin e kaluar.

**Armend Zemaj**- Nga praktika e dimë se rishikimi i buxhetit nuk lejon mundësi të shumta të ketë lëvizje buxhetore, sepse buxheti kalendarik është baza dhe planifikimi që merret për një vit buxhetor. Do doja që këtu të ketë përparësi sepse pothuajse çdo dikaster i Ministrisë së Drejtësisë është përfshirë në kërkesën buxhetore dhe kjo është e pamundur që të realizohet sepse po t'i mbledhim shumat del që është e madhe dhe sigurisht që nuk do të jetë mundur. Mendoj se Avokatura Shtetërore është anashkaluar edhe nga vëmendja jonë, por edhe nga vetë zbatimi i ligjit. Ne, që nga miratimi i këtij ligji, nuk kemi arritur të shohim zbatimin e ligjit edhe pse kemi caktuar që të bëjmë një vizitë në Avokaturën Shtetërore për disa shkresa që na i kanë dërguar, por mbi të gjitha të shohim edhe funksionimin e saj. Të gjitha kërkesat nga Ministria e Drejtësisë janë të rëndësishme, por prioritet më shumë t'i jepet Avokaturës së Shtetit me shumën prej 41,806.80 për nivelimin e pagave të avokatëve të shtetit.

**Selvije Halimi** tha se ne, si Komision, na takon t'i mbështesim kërkesat përkatëse që janë në fushëveprim të Komisionit. Mendoj se duhet t'i japim mbështetje kërkesave dhe mund po ashtu të shkojmë me prioritet të kërkesave për rishikim të buxhetit, por mos të hymë në detaje sepse nuk është fushë e jona dhe nuk kemi mundësi që të propozojmë se ku mund t'i marrim mjetet financiare. Fuqizimi i këtyre institucioneve duhet bërë sepse mos realizimi i planit për shkak të mungesave buxhetore shkakton problem.

**Agim Aliu** tha se jemi dakorduar edhe në mbledhjet e mëhershme që t'i mbështesim institucionet që janë në fushëveprim të Komisionit. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas për 48.000.00 € nuk duhet të jetë në asnjë mënyrë e pa përfshirë në pjesën e rishikimit të buxhetit dhe dakordohem që edhe Avokatura Shtetërore të përkrahet.

**Agim Ademaj** tha se rishikimi i buxhetit lë pak mundësi për realizim nga disa kërkesa që janë paraqitur. Te kërkesa e Ministrisë së drejtësisë unë jam që t'i jepet përkrahje Avokaturës Shtetërore dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës shuma prej 58,352.00 për kompensimin e punës së natës, festave shtetërore dhe rekrutimin e pozitive të lira buxhetore.

**Danush Ademi** tha se jam kundër këtyre pozitive shtesë që janë kërkuar sepse nuk ka sqarime se a do të ketë punësime nga komunitet dhe përderisa nuk sqarime ne nuk do t'i përkrahim. Kërkoj që me shkrim të ketë sqarime se a është paraparë të ketë punësim edhe për komunitetet lidhur me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë për staf shtesë prej 10 pozitash.

**Nezir Çoçaj** tha se i përkrah Avokaturën e Shtetit dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës me shumatat e përcaktuara.

**Kryetarja** tha se sa i përket Institutit Gjyqësor të Kosovës tashmë është në fazën e transformimit në Akademi të Drejtësisë dhe mendoj që në buxhetin e ardhshëm mund t'i kemi më qarta prioritetet e këtij institucioni. Ndërsa për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas kryetarja tha se e mbështes propozimin e z. Aliu për t'i ndarë buxhet shtesë kësaj agjencie, por Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka kërkuar që t'i lejohet pozita e një zyrtari në Mitrovicë në shumë prej 5,610.00 € për shkak të lëndëve të cilat procedohen në këtë rajon dhe për pagesat e avokatëve të angazhuar për përfaqësim të palëve në procedurat gjyqësore në shumë prej 10,000.00. Po ashtu edhe z. Nezir Çoçaj e mbështeti propozimin e z. Aliu për ri funksionalizimin e zyrave për Ndihmë Juridike Falas në Ferizaj dhe Gjakovë.

**Armend Zemaj** tha se Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas komunitat t'i mundësojnë të kenë zyrë që t'i kryejnë funksionet e saj, sepse nuk do të kenë kosto buxhetore përveç shpenzimeve të tjera që mund të kenë.

**Agim Ademaj**- Sa i përket ri-funksionalizimit të zyrave për Ndihmë Juridike Falas në Ferizaj dhe Gjakovë në shumë prej 48.000.00 i përkrah ndërsa për kërkesat tjera mos të futen sepse në këtë fazë t'i përkrahim ri-funksionalizimin e këtyre dy zyrave dhe në fazat e tjera mund t'i përkrahim kërkesat që kanë mbetur.

**Kryetarja** tha se janë dy propozime: e para është që t'i ndahet buxhet shtesë Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për rifunksionalizimin e zyrave për ndihmë juridike falas në Ferizaj dhe Gjakovë ndërsa e dytë është që të përkrahet në tërësi kërkesat e kësaj Agjencie.

*Pas diskutimit të anëtarëve të Komisionit kryetarja konstatoi që me shumicë votash (4 për dhe 3 kundër) përkrahen në tërësi kërkesat e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.*

**Kryetarja** tha se Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka kërkuar 48 pozita shtesë për gjyqtarë dhe 115 pozita për staf administrativ për gjykatat e pjesës veriore të Kosovës në funksion të zbatimit të Marrëveshjes për Drejtësi. Edhe unë personalisht, por edhe si Vetëvendosje e kemi kundërshtuar këtë marrëveshje. Kjo marrëveshje në secilën pikë të saj bie ndesh me Kushtetutën e Republikës

së Kosovës. Unë nuk e përkrah këtë kërkesë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, madje është për keqardhje se si KGJK është përfshirë në procesin negociator me Serbinë sepse është një institucion i pavarur dhe nuk mund të negociojë për çështje politike në Bruksel.

**Armend Zemaj** tha se ne kemi biseduar edhe me përfaqësues të KGJK –së dhe besoj se Qeveria e ka parasysh sepse duhet të jetë edhe implementues të marrëveshjeve në zbatimin e integritit të sistemit gjyqësor në vend. E mira është që të gjithë do t'i nënshtrohen Kushtetutës së Republikës së Kosovës të gjithë ata që punojnë në fushën drejtësisë dhe sigurisë dhe nëse i shohim në mënyrë selektive atëherë do të gjejmë vërejtje të gjitha. Me ligjin për gjykatat ne kemi vendosur për funksionalizimin e degës për Fushë- Kosovë, Shtimes dhe Junikut. Për degën e Fushë- Kosovës ka qenë e planifikuar nga ata, ndërsa për degën e Shtimes dhe të Junikut ka vendos Komisioni jonë. Në kërkesë është e përfshirë vetëm dega në Fushë- Kosovë dhe sigurisht këto degë të tjera janë lënë për buxhetin e vitit 2017.

**Danush Ademi**- Kërkoj që 10 pozita shtesë që ka kërkuar KGJK për funksionalizimin e degës në Fushë Kosovë edhe në këto pozita të ketë edhe nga komuniteti dhe nuk e shoh të arsyeshme t'i përkrah pa na u dhënë sqarime sepse nëse po votohet, ato po shkojnë në pako dhe nuk e dimë se çfarë po bëhet.

**Armend Zemaj** sqaroi z. Ademi duke i thënë se anëtari i KGJK-së është nga komuniteti yt. KGJK është institucion i pavarur, është kategori kushtetuese dhe aty mbrohen interesat dhe të komunitetit tuaj. Kushtetuta e përcakton që edhe komunitetet jo shumicë ta kenë anëtarin e vet në KGJK. Do të ishte mirë që edhe ju, por edhe ne nëse është e nevojshme të kërkojmë llogari se sa ai lufton për të drejtat e komiteteve dhe zbatimit të ligjit në tërësi.

*Komisioni pas diskutimeve dhe votimit një për një të secilës kërkesë të KGJK-së vendosi që me shumicë votash të përkrahet 48 pozita për gjyqtarë dhe 115 pozita për staf administrativ për gjykatat e pjesës veriore të Kosovës në funksion të zbatimit të Marrëveshjes për Drejtësi (3 vota për, 2 kundër dhe 2 abstenime) dhe u përkrahën 10 pozita shtesë për funksionalizim të degës në Fushë Kosovë (5 vota për dhe 2 vota abstenim)*

*Komisioni pasi shqyrtoi një për një secilën kërkesë buxhetore të institucione që janë fushëveprim të Komisionit, Ministrisë së Drejtësisë, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës me shumicë votash vendosi që Ministrisë së Financave dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa t'ia paraqet këtë:*

### **Rekomandim**

1. Të ndahet buxhet shtesë për Ministrinë e Drejtësisë, me theks të veçantë për Avokaturën e Shtetit dhe Shërbimin Korrektues të Kosovës, për kërkesat e paraqitura në shkresën e datës 2.6.2016.
2. Të ndahet buxhet shtesë për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, në tërësi, për kërkesat e paraqitura në shkresën e datës 1.6.2016.
3. Të ndahet buxhet shtesë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me theks të veçantë, të përkrahen 48 pozita për gjyqtarë dhe 115 pozita për staf administrativ, për gjykatat e pjesës veriore dhe të përkrahen 10 pozita shtesë në funksion të Ligjit për gjykata, për funksionalizim të degës në Fushë-Kosovë, për kërkesat e paraqitura në shkresën e datës 2.6.2016.

## **5. Të ndryshme**

**Kryetarja-** Njoftoi se në bazë të nenit 34 të Rregullores së Kuvendit ju dërgoi kërkesën e Gjykatës Kushtetuese lidhur me rastin KO 94/16 dt. 28 qershor 2016 të deputetit Slavko Simiq, përfaqësuesve të 10 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtimin e kushtetutshmërisë të Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës të miratuar në seancë plenare të Kuvendit më 9 qershor 2016.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**